

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda**, kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Beqir Kalludra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit Arianit Mahmutaj, procesmbajtës, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. B., nga fshati M., komuna e S., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së shtetit, PP/I.nr.115E/2013 të dt.19.03.2014, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.14.11.2016, në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit Bukurije Gjonbalaj dhe i akuzuari, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht këtë:

## A K T G J Y K I M

I akuzuari **I. B.**, i biri i S. dhe M., e gjinisë B., i lindur më *data e lindjes...*, në P., me banim në fshatin M., komuna e S., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, student i fakultetit të arteve, dega e grafikës, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në vuajtje të dënimit për veprë tjetër penale të llojit të njëjtë.

## Ë S H T Ë F A J T O R

**Sepse**

Me dt.14.12.2011 rreth orës 15.30 min., në rr. "UÇK-së", është ndalur nga njësitë policor, dhe gjatë kontrollës i është gjetur një qese me substancë narkotike e llojit marihuanë dhe gjatë kësaj kontrole nga ana e policisë, i njëjti kishte pranuar faktin se në banesën ku banon e cila gjendet në lagjen U. tek F., kishte edhe sasi tjetër të kësaj substance narkotike, ku edhe gjatë kontrollimit të banesës nga ana e policisë, është gjetur dhe sekuestruar substanca narkotike e llojit marihuanë, me peshë të përgjithshme prej 450.67 gram, të cilën i akuzuari e ka poseduar në mënyrë të paautorizuar dhe me qëllim shitjeje.

-me këtë ka kryer veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPRK-së,

Prandaj gjykata konform dispozitave 2, 4, 41, 45, 46, 73, 74 dhe 229 par.1 dhe 5 të KPRK-së si dhe nenit 359, 365, 367, 368, 450, 453 të KPPRK, e:

## G J Y K O N

**ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

**ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 800 (tetëqind) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar t'a paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm.

Detyrohet i akuzuari që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësorë,

shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të akuzuarit i konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë prej 450.67 gram, mjet ky me të cilën është kryer kjo veprë penale, dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka paraqitur aktakuzë PP/I.nr.115E/13 të dt.19.03.2014, kundër të akuzuarit I. B., për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, me dt.14.11.2016, dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari, e ka pranuar në tërësi fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale me të cilën është akuzuar.

Prokurori i shtetit nuk ka pas vërejtje në deklaratën e të akuzuarit për pranimin e fajësisë.

Meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranim i cili është bërë vullnetarisht, pranim i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPRK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetohet se në veprimet e të akuzuarit I. B., manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike nga neni 229 par.1 të KPRK-së, ashtu që të akuzuarin edhe e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj sanksionin penal përkatës, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prokurori i shtetit në fund ka deklaruar se meqë i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i ka propozuar gjykatës, që me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e sanksionit penal, që ta merr parasysh pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e zhvillimit të kësaj procedure penale dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ashtu që këto rrethana ti vlerësoj si rrethana lehtësuese.

I akuzuari I. B. në fund i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të çfarëdo sanksioni penal ti vlerësoj të gjitha rrethanat relevante lehtësuese për shqiptimin e një dënimi sa më të butë të mundshëm, duke e lutur gjykatën që ta ketë për bazë edhe një dënim të plotfuqishëm me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite e 2 muaj, dhe një gjykim i cili ende nuk është i plotfuqishëm me dënim me burgim prej 18 muajsh, që të dyja këto dënime për substancë narkotike të llojit marihuan (për rastin e dytë bëhet fjalë për një veprë penale me një peshë të vogël dhe atë vetëm për një bimë), gjithashtu i njëjti ka shpreh pendim të thellë para gjykatës për këto veprime që i ka

ndërmarr në të kaluarën, ka qenë edhe përdorues i kësaj substance, në ndërkohë tani më ka pushuar së konsumuari, dhe gjithashtu i premtom gjykatës se në të ardhmen asnjëherë nuk do të ndërmerr veprime të tilla apo të ngjashme, duke shtuar se i njëjti nga këto veprime në të kaluarën e tij ka mësuar shumë.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të akuzuarin, i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori faktin se, i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sigurtë që nga fillimi i kësaj procedure penale si dhe sjellja dhe qëndrimi i tij shumë korrekt në gjykatë, pendimi i thellë i tij për këtë veprë penale, premtimi i të njëjtit se në të ardhmen nuk do ti përsëris asnjëherë këto veprime, si dhe gjendjen e vështirë ekonomike, e si rrethana rënduese gjykata vlerësoi faktin se i njëjti është gjykuar edhe njëherë për këtë lloj të veprave penale, ashtu që të akuzuarit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal, është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të akuzuarit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 50 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale kundër të akuzuarit, do të merret në bazë të llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërkaq shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor janë marrë, duke pasur për bazë ndërlikueshmërinë e veprës penale, kohëzgjatjen e zhvillimit të procedurës penale si dhe gjendjen pasurore të të akuzuarit, konform nenit 450 par.3 të KPRK-së. Vendimi lidhur me konfiskimin e substancës narkotike është marrë konform nenit 229 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.143/14, dt.14.11.2016**

**Procesmbajtësi**  
Arianit Mahmutaj

**Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari**  
Beqir Kalludra

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.